

Flora Brovina

Gazetare dhe mjeke

Quhem Flora Brovina, jam e lindur me 30 shtator 1949 në Skenderaj, Drenicë. Me profesion jam tash pensioniste, ish politikane, domethanë në kuptimin deputete në gjashtë mandate, të parlamentit të Kosovës. Me përvojë shumë vjeçare si pediatre, me studime të kryera në Zagreb, me postdiplomë dhe specializim. Ish gazetare e Rilindjes dhe për këtë intervistë shumë e lumtur që pata mundësinë me folë për Rilindjen.



Në foto: Flora Brovina

Nga arkivi personal i Flora Brovinës

Unë isha studente e Mjekësisë dhe nuk kisha ëndërru ndonjëherë që të bëhem gazetarë, mirëpo ndodhi që gjatë studimeve fillestare që i fillova në Beograd, atje kam dëgju vitin e parë dhe të dytë, i kam dhanë provimet e vitit të parë. Mora një inspirim nga Televizioni i Prishtinës që u jepeshte nga Beogradi, dhe fillova të merrem me gazetarinë hera e parë. Dhe, fillimi ishte një reportazh për teknologjen e parë studente ishte ajo atëhere, Hafize Avdiu, e cila ishte nga Mitrovica dhe ishte studentja e parë në fakultetin e Teknologjisë, pra inxhinierja e parë shqiptare në Kosovë, teknologe. E kjo më inspiroi dhe unë bëra një reportazh për te që pati shumë sukses. Kjo është fillesa e ime, një inspirim që nuk e dita që e kam por e zbulova atje.

Mirëpo, unë shpejtë mas kësaj, domethonë në vitin e dytë, do të kthehem në fakultetin e Prishtinës mbasi që këtu ishte hapë Mjekësia, dhe masi jetoj në Prishtinë, unë e kisha shumë lehtë të studioj këtu. Kur e pashë shpalljen, unë kisha fillu të drejtën me thanë, kisha fillu edhe të botoj vjersha, e ndoshta si sfidë me burrin tim, sepse në atë kohë nuk kishte shumë poete.

<<< Ambient i hollit të Rilindjes >>>

100 veta ishin në konkursin që u hapë në Rilindje. Ishte një sallë shumë e madhe, kishte njerëz që unë i njihja, kështu si figura të njohura ose autorë, ose diçka, mirëpo, kishte edhe femra dhe hyra në sallë, pak e dëshprume nga gjithë ajo konkurrencë, nuk e dija se a do të pranohem. Dhe nejse, e plotësova, pyetje shumë kishte, dhe kur dëgjova që jam pranuar, thash “Pse do të më kenë pranuar?”, “Pse a thu?”, “A kam ditë a thu prej 100 mirë?”, “Po, sigurisht, pse jom femër”, dhe kështu nuk pranoj me qenë. Edhe shkova te redaktori... shkova atë ditë, i thash “M’falni kom ardhë”, tha “A sa mirë”, më priti shumë mirë. I thash, “I kom dy pyetje, e para osht’ pse më keni pranuar? Pse jom femër?” thash, “Po ju tregoj të drejtën i kam dy arsye”. I thash, “Unë jam studente e fakultetit të Mjekësisë, asni student nuk punon në fakultetin e Mjekësisë, osht’ qaq fakultet i vështirë sa s’ki mundësi me punu, dhe unë nuk kam kohë me mësu tashti gazetari. Por a më keni pranuar pse kom ditë, a pse jom femër? Qe kjo është pyetja”. Tha “Prit” tha, “Ulu”. I mori dosjet edhe më tha, “Vetëm një para teje ka ditë ma mirë se ti dhe ai është Jusuf Gërvalla”. Isha shumë e lumtur që më tha, tha “Në pyetjet që je përgjegj, jemi befasu që mund të zgjedhim edhe gazetarë edhe reportere e sportit, sepse e ke ditë”. Atëherë është mbajtur Olimpiada në München, dhe unë paskam qëllim në rezultatet e sportit atje, çfarë kanë qenë, ku ne s’kemi marrë pjesë, por unë i kam përcjellë, dhe ky ishte një frymëzim, thash, “Mirë, atëherë”, e pranova kur m’u argumentuan të gjitha këto. Tani, e përfundova pse kom hy.



*Në foto: Flora Brovina
Nga arkivi personal i Flora Brovinës*

Nga gazetaria do të marr qaq shumë dashuri, do të marrë qaq shumë... do të më mësojë qaq shumë me jetën, sa që unë i mbetem asaj borxh. Nga gazetaria sikur fluturoja sikur një flutur, si... kurrë s'kam punu në një televizion, në këto mediumet e tjera, vetëm në gazetë. Por ishte diçka vetë Rilindja, ishte një simbol i ni shprese, i ni hapje, e gjitha aksioneve, ose e ecjeve tutje. Takimi i parë me personalitete, që unë i kisha njoftë vetëm përmes leximit ishte gjithashtu... e të drejtën me thonë atë kohë ju se besoni, por po flas për një kohë, 50 e sa vjet, gati 60 a, 50 e sa, unë i kam 74 tash, gazeta kishte rubrika të veçanta. Disa u morrën Jusufi e këta, kaluan në rubrikën e kulturës, unë për shkak të asaj që m'u dha, edhe pse praktikante do t'a përcjellja shëndetësinë dhe çështjet sociale. T'drejtën, t'drejtën, kjo, e përcjellja, dhe njohja me çështjet sociale, edhe prej babit tim, por edhe prej përvojës në gazetari, shumë më ka ndihmu edhe si deputete.

E tani, përvoja ime ishte shumë e çuditshme, sepse edhe bashkëbiseduesit shpesh herë ishin burra, dhe në terren duhet të shkojsh me ta, me burra, me gazetarë, me fotoreporterë, me shofera. Por u mësova dhe kjo më ka bo shumë të pavarur, kjo m'a ka dhuru lirinë. Përveç bazës materiale, se rrogat ishin të vogla, sa për ta mbajtur vetën si ni bursë e studentit, por këtë pavarësi

personale, ma ka mësu gazetaria. Sidomos dashurinë për Kosovën. Sepse hap ëm hap, e... s'po them n'shpi ëm shpi, por do t'a them, se edhe n'shpi ëm shpi gati kom shëtitë si gazetarë. Ka pasë edhe momente të mira, edhe momente të vështira, por ka pasë edhe momente pak ma të lehta. Një ndër ato të vështira ka qenë epidemitë, epidemia e Variolës, epidemia e Tifos në regjionin e Rahovecit, në regjionin e rrethit të Prizrenit ku unë gati çdo ditë kom shku edhe kom kontaktu dhe kom referu për gjendjen atje. Sikur tash kur ka urgjenca e dini kur epidemia kur ishte. Tjetër, ndonjëherë merrshim aksionin në vetë, që të frymëzojmë shkollimin e femrave, dhe vetë prezenca ime ishte një fakt që jam aty, dhe "Ja, në qoftëse ju pëlqen modeli dhe vajza e juaj këtë model le ta merr". Prandaj duhesha me qenë shumë me takt në komunikim me këta njerëz. Ndonjëherë i disha rrethanat, ndonjëherë jo.

<<< Ambient në makinë gjatë vozitjes në fshat >>>

Në aksionin për shkollimin e vajzave, e mu m'u caktu terreni i Drenicës, kështu që kur shkova isha e shkarkume prej paragjykitimeve, ose prej asaj normave të sjelljes. Por i dija normat e sjelljes, qytetarët tonë, prandaj nuk kisha problem në këtë pikëpamje.

Para disa ditëve në Gllanasellë, kështu është qujtë përpara, tash Driton, një fshat, u mbajtë një tubim i luftëtarëve, u qel një pllakë përkujtimore dhe isha e ftuar nga familja Lladrovci, nga shoktë e Adem Jasharit. Dhe e pata një pritje të veçantë, dhe pasi u kry manifestimi, desha të takohem me gratë, e kjo për herë të parë po e tregoj këtë ngjarje, që e kam shumë... shumë më ka lanë përshtypje. Kanë kalu pra shumë vite, edhe njëna nga ato, që dukeshite sipas veshjes ma e emancipume, erdhi më përqafoi dhe më tha, "Doktorreshë, sa kom qef që të shof", tha "Je ti ajo që ke bo që unë t'jem ma e shkolluara në këtë mes dhe sot punoj", thash "Nuk po kuptoj" a din, "Si ka ndodhë kjo punë, sepse mund ta kem harru?", tha, "Ti ke ardhë dhe ke folë me gjyshin tim, e pllaka po hapet për gjyshin tim, sot kjo ceremoni u mbajt për gjyshin, dhe ti ke ardhë". E çka ka ndodhë, tashti çka ka ndodhë e vërteta? Unë kam shku, pa e ditë zakonisht, kom trokitë në derë, kom thonë "Mirëdita", "Mirëdita", kam thanë, "Kush ashtë ma i vjetri në shpi?", ka thanë "Gjyshi", "Po ku është gjyshi?", ka thanë "Këtu". Unë e dijsa që ata kanë vajza që nuk i lajnë t'shkojnë në shkollë, dhe u ula me gjyshin, them, "Ta dërgoni vajzën në shkollë", kështu, kështu... Fola me të dhe ai ma dha dorën. Kaq, [qeshë lehtë] kaq ka qenë.

Kur hymë në Rilindje, ende s'ishte kry kjo pjesë, nuk ishte kry, dhe hymë në katin e pestë. Të drejtën, ka pasë në fillim disa probleme, ka pasë me ashensorin, ka pasë probleme me nxemjen, por ishte një hapësirë shumë e madhe, sidomos pamja t'jepte një frymëmarrje. Mirëpo për fat nuk do të punoj shumë gjatë, në këtë objekt. Diplomova, dhe po prisja me m'thanë, "A po kalon, në mjekësinë e punës?". Dhe bona kërkesën, që të ma japin specializimin, edhe të shkoj të specializoj në mjekësinë e punës. "Oh" tha, "Jo", m'tha redaktori që deri dje e kisha, tha, "Si po mendon, ti me shku tash me specializu?", ai mendonte se do të shkoj dikund e do të vonohem katër vjet. Tha "Jo" tha, "Na e shpallim konkursin edhe vjen, punëtori i gatshëm, mjeku i gatshëm specialist". Ajo qaq më la përshtypje e thash, "Po, unë, edhe të gjithë punëtorët kemi kursy për këtë objekt, edhe kemi andrru për vendet tona të punës, sigurisht e kemi pasë një

synim, edhe unë kam ndejtë kaq gjatë, kaq gjatë pa shku në profesionin tem, ku isha zhvillu, t'u pritë që do ta marrë këtë ambulancë". Dhe u revoltova shumë, dhe, edhe pse kisha diplomu, pra punova edhe një vjet e sa si gazetarë. Ishte viti '81, ishte viti shumë i vështirë, për dallim prej atyne viteve, që i përmenda që ishin ma të bukurat, e ky vit ishte i vështirë, politikisht. U bonë demonstratat, shoku im më i ngushtë, iku prej Kosovës, pra Jusufi. Atë e kisha shokun më të ngushtë, edhe që ja shprehsha të gjitha revoltën time, nganjëhere më kritikonte. Ndonjëherë desha t'jem pjesë e ilegales, tha "Jo, ti jo, sepse ti e ki familjen të etiketume dhe mënjëherë bjen në sy dhe na dëmtton", dhe thot, "E dyta për shkak se do të vjen momenti dhe ti do ta dish vetë se ku të bashkohesh, pra në atë moment ti e din ku e vendin dhe do të jesh pjesë e jona, po momentalisht kursehu". Edhe kështu ndodhi. Fillunë politika ndryshe, njerëz tjerë u avancunë, filloi ni diçka që më nuk më pëlqente mo në Rilindje, ni diçka që u ballafaqova, që ishte më e randa, përpos kësaj të Mjekësisë, ishte temat e imponume, tema, për shembull "Merre temën, shkruj kundër doktorreshës Sadete Mekuli, kundër", unë me shkru për Sadete Mekuli, kundër, për mu ishte idoli i Mjekësisë, e si t'shkruj kundër? Thash, "Unë kurrë s'shkruj kundër, nuk do ta bëj", "A din që dënohesh?", "Po dënom de hajt", qe. Dhe erdhën njerëzit e dyshimtë aty tashti në krye, të drejtën me thanë, protesat e studentëve më banë që të filloj punën para se të inkuadrohem në profesion. Mjekët mungonin, mjekë shqiptarë s'kishte, e kisha vendosë tani të punoj.



Gjatë redaktimit të shkrimeve

Në foto: Flora Brovina

Nga arkivi personal i Flora Brovinës

Dhe e lashë Rilindjen. E në Rilindje ma kurrë s'kom shku. Domethonë e kom atë... a din kur, e ke një dashuri të madhe edhe ndahesh edhe thu, "As mos t'a shoh rrugës se më shqetëson", e qe qajo osht'. S'di kush m'tha që ish hapë një ekspozitë e fotove të fëmive viktime të luftës, dhe pyeta, "Ku?", tha "Në foajenë e objektit të qeverisë", thash, "Në Rilindje?", tha, "Po", oh thash sa keq, vetë me vete, "Nuk mund të shkoj". Më lidhet me gjithçka. Dhe kur u bo objekti, objekt i shtetit, s'e di çfarë ndjenje kom pasë, diqysh kom mendu që do t'a bon objektin e vetë, sepse u morrën dy tri objekte, nuk ishte zgjidhje shumë e mençur, edhe kuvendi u morr, edhe presidenca dhe kuvendi domethonë sot e asaj dite, deputetët s'kanë asnjë dhomë ku mund të pranojnë palët, edhe gazetaria u shu. Unë i kom kushtu edhe poezi, jo Rilindjes, po kioskut të Rilindjes, ku shkojmë e blejmë gazeta. Sot për shembull kom mall për një gazetë që quhet "Rilindje" dhe thjeshtë e ndjej mungesën sikur të më kishte vdekë një pjesë e përvojës time jetësore, dhe do të ju lexoj poezinë.

Kiosku Rilindja

Viti 1991 e kam shkru, nga malli.

Rebelimin s'ta shuan, as prangat kur t'i vuan

Në qytetin e studentëve

Durë lidhur rri, kryeneqe pret

T'a rilindin, t'a rinojnë, të ia heqin prangat.